



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1085/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjohë në shumë prej 4,000.00 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se Kryetari i subjektit politik NISMA, dega në Prizren, Zafir Berisha, përmes rrjetit social Facebook ka thyer heshtjen zgjedhore, pasi që me datë 19.11.2017 në orën 7:22, në profilin e tij në facebook ka publikuar një fotografi me përshkrimin: “Dilni çlirone Prizrenin nga hajdutët, duke votuar numrin 10!” Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me nenin 36 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LVV ka theksuar se në legjislacionin zgjedhor në fuqi nuk mund të gjenë asnjë dispozitë ligjore sipas të cilës, subjekti politik sanksionohet kur një anëtar i një subjekti tjetër i cili është në koalicion me të publikon apo thyen heshtjen zgjedhore. Po ashtu në përgjigje LVV kanë shtuar se neni 36 paragrafi 1 pika b ka të bëjë vetëm me subjektin e caktuar politik mbështetës dhe kandidatët e tij, duke përjashtuar kategorikisht anëtarët e subjekteve tjera politike në cilësinë e mbështetësve për subjektin tjetër

politik për faktin se kjo mbështetje në këtë rast rrjedh nga koalicioni të cilin nuk e njeh Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografinë e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se Kryetari i subjektit politik NISMA në Prizren, Zafir Berisha, në profilin e tij në facebook, ka shpërndarë një postim në të cilin shihet se ka përmbajtje të fushatës zgjedhore po ashtu duke përdorur fjalë fyese, në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 19.11.2017 në ora 7:22, ku bënë thirrje që të votohet kandidati për Kryetarë të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik LVV, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

Sa i përket pretendimeve të subjektit politik LVV se marrveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV-së dhe Nismës nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto dhe legjislacioni në fuqi nuk i njeh kolicionet politike mbi të cilën mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjetër politik, mirëpo këto pretendime paneli i vlerësoi se nuk qëndrojnë sepse dispozita ligjore e nenit 32.5 *përcakton subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.* Me këtë rast Paneli konstaton se është fakt notor i publikuar përmes mediave se subjekti politik Nisma mbështet kandidatin e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje për kryetar të Komunës së Prizrenit, dhe Zafir Berisha në cilësinë e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të LVV-së për kryetar të komunës së Prizrenit gjatë kohëzgjatjes së heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin për Kryetar Komune nga radhët e subjektit politik LVV me të cilën i bëhet thirrje votuesve të votojnë numrin 10, andaj në këtë bazë rrjedh edhe përgjegjësia e subjektit politik LVV-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LVV ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë mohuar shkeljen e supozuar, si dhe nuk kanë ofruar prova se kanë vepruar sipas nenit 32.6. Pretendimet e LVV-së në përgjigje në ankesë nga ana e Panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Paneli me rastin e caktimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi po ashtu mori parasysh si rrethan rënduese edhe përdorimin e fjalorit denigrues, nga ana e personit i cili ka bërë shkeljen.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

ZL.Anr.1085/2017 me datë 21.11.2017



Kryesues i Panelit
Hasan Shala

Udhëzim Juridikë:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*